

VENDIM
Nr.292,datë 6.5.2005

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.315, DATË 23.6.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT TË TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TRAJNIMIN E NËPUNËSIT CIVIL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.315, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në shkronjat “c” pika 4, dhe “dh”, “f” e “h”, pika 7, fjalët “...trajnerët e përhershëm...” zëvendësohen me “...menaxherët e trajnimit...”.

2. Në fund të pikës 5 shtohen fjalët “..., një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.”.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/a, me këtë përmbajtje:

“5/a. Ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera të administratës qendrore përcaktojnë deri në muajin qershor të çdo viti, nevojat për trajnime për nëpunësit e tyre gjatë vitit pasardhës dhe ia paraqesin për veprim Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.”.

4. Paragrafi i parë i pikës 8, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Veprimtaria trajnuese zhvillohet nën drejtimin e menaxherëve të trajnimit, të cilët organizohen sipas veprimtarisë në qendrën e trajnimit të përgjithshëm dhe në qendrën e trajnimit fiskal të këtij instituti. Menaxherët e trajnimit kanë këto detyra:”.

5. Në pikën 10 fjalët “...e përbërë prej tre personash...” shfuqizohen.

6. Shkronja “c” e pikës 11, ndryshohet si më poshtë vijon:

“c) të ardhurat që jepen nga ministrinë e ndryshme apo institucionet e tjera, për nevojat e trajnimit të nëpunësve të tyre.”.

7. Në pikën 19 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fjalinë e parë të paragrafit të parë, fjalët “...pagën bazë...” zëvendësohen me “...pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune...”.

b) Në shkronjën “a”, fjalët “...e pagës bazë...” zëvendësohen me “...pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune...”.

c) Në shkronjën “b” fjalët “...e pagës bazë...” zëvendësohen me “...pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune...”.

8. Në pikën 20 fjalët “...e pagës bazë...” zëvendësohen me “...pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune...”.

9. Tre punonjësit, që kanë kaluar nga organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në organikën e Këshillit të Ministrave, me vendimin nr.209, datë 7.4.2005 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në vendimin nr.124, datë 2.3.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve buxhetorë të ministrive dhe institucioneve qendrore, për vitin 2005””, të jenë pjesë e organikës së Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.

10. Në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në zërin “Paga dhe sigurime” pakësohet shuma 2 313 000 (dy milionë e treqind e trembëdhjetë mijë) lekë, e cila shtohet në buxhetin e po këtij viti, miratuar për Këshillin e Ministrave, për Institutin e Trajnimeve të Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano